



Datë: 26.06.2026

NJOFTIM

PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR APLIKIM NË THIRRJEN PUBLIKE PËR PËRKRAHJEN FINANCIARE TË START-UP BIZNESEVE INOVATIVE DHE BIZNESEVE TË REJA

Komuna e Fushë Kosovës, përmes Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë, njofton të gjithë të interesuarit se afati për aplikim në kuadër të **Thirrjes Publike për përkrahjen financiare të start-up bizneseve inovative dhe bizneseve të reja në Komunën e Fushë Kosovës për vitin 2026**, shtyhet deri më datë **30.06.2026, ora 16:00**.

Shtyrja e afatit bëhet me qëllim të ofrimit të kohës shtesë për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimeve cilësore nga të gjithë aplikuesit e interesuar, si dhe për të mundësuar pjesëmarrje sa më të gjerë në këtë thirrje publike.

Të gjitha kushtet, kriteret, dokumentacioni i kërkuar dhe mënyra e aplikimit mbeten të pandryshuara, sipas kushteve të përcaktuara në thirrjen publike të publikuar paraprakisht.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda afatit të ri të përcaktuar, përkatësisht deri më **30.06.2026, ora 16:00**.

Për informata shtesë lidhur me thirrjen publike, të interesuarit mund t'i referohen dokumentacionit zyrtar të thirrjes ose të kontaktojnë Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë në Komunën e Fushë Kosovës.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë
Komuna e Fushë Kosovës

